



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1539 / prot.

Tiranë, më 08/05/2020

URDHËR

Nr. 301, datë 08.05.2020

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME

NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.03.2020“PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË“

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të Ligjit nr.15/201,“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19 në Republikën e Shqipërisë,

URDHËR O J:

1. Në Urdhrin Nr. 193, datë 20.03.2020“Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë“, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pas pikës 3/1, shtohet pika 3/2 me përmbajtje:

“3/2 Lejohet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bizneset e mbyllura sipas listës bashkëlidhur Urdhrit Nr. 193, datë 20.03.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, sipas Tabelës.1 bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga data 11 Maj 2020, brenda fashës orare 08:00-17:30.”

2. Shërbimet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij Urdhri kryhen duke respektuar protokollet e sigurisë, të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij Urdhri.

4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e Urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Urdhrat e tjerë që bien në kundërshtim me parashikimet e këtij urdhri shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu



Tabela 1

KODI NVE 2 DIGIT	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	STATUSI I AKTIVITETIT
50	Qendra Tregtare (përfshijë baret,restorantet dhe aktivitetet e destinuar për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve)	Lejohen
136	Aktivitetet e tjera shërbimi (Trajtime Estetike, mireqenie fizike, përfshijë palestra) Këtu përfshihen aktivite te të trajtimit të flokut dhe trajtime të tjera të bukurisë, të detajuara sipas Nomenklaturës së Aktivitetëve Ekonomike.	Lejohen